

Ngritja dhe formalizimi i Task Forcës për Integritetin Akademik në 5 institucione partnere të Ballkanit Perëndimor (projekti Erasmus + SINCERE): Roli i Universiteti “Eqrem Çabej” Gjirokastrë (EÇUG)

Në kuadër të projektit **SINCERE**, u organizua takimi i katërt online koordinues (19.01.2026). Universiteti “Eqrem Çabej”, Gjirokastrë (EÇUG) është një nga tetë institucionet partner të konsorciumit dhe mban rolin e **institucionit udhëheqës për Task-un T2.1**, që lidhet me **ngritjen dhe formalizimin e Task Forces për Integritetin Akademik (TFAI)** në institucionet partnerë të Arsimit të Lartë në Shqipëri dhe Kosovë.

Veprimtaria për ngritjen dhe validimin e TFAI përbën një kërkesë të detyrueshme që buron nga **WP2 “Designing, validating and operationalizing the Academic Integrity Framework”**, konkretisht nga **Task T2.1 “Establishment of the TFAI”**, dhe duhej të përmbushej brenda muajit të katërt të zbatimit të projektit (M4). Në këtë proces, EÇUG ushtroi rolin e institucionit përgjegjës për **ndjekjen, mbikëqyrjen dhe validimin** e procedurave të ndjekura nga institucionet partnere. Gjithashtu EÇUG ishte përgjegjës për përgatitjen e **Deliverable D2.1 – Establishment and Formalization of Academic Integrity Structures**, i cili dokumentoi ngritjen dhe zyrtarizimin e strukturave për integritetin akademik në pesë (5) institucione të arsimit të lartë të Ballkanit Perëndimor, partnere në projekt.

Mbledhja e të dhënave u realizua përmes dorëzimit të dokumentacionit zyrtar nga institucionet partnere, në përputhje me procedurat e tyre të brendshme administrative dhe vendimmarrëse.

Në kuadër të zbatimit të Task T2.1 dhe përgatitjes së Deliverable D2.1, Universiteti “Eqrem Çabej”, Gjirokastrë (EÇUG) ngriti Task Forcën institucionale për Integritetin Akademik, e cila kontribuoi drejtpërdrejt në mbledhjen, përpunimin dhe dokumentimin e të dhënave nga institucionet partnere, me kontributet specifike:

Valbona Duri, në cilësinë e Kryetarit të Task Forces – ishte përgjegjëse për koordinimin e përgjithshëm të procesit, mbikëqyrjen e mbledhjes dhe validimit të dokumentacionit, si dhe për rishikimin përmbajtësor dhe harmonizimin strukturor të raportit në përputhje me kërkesat e Deliverable D2.1 dhe WP2/T2.1.

Isidor Kokalari dhe **Marsel Kikino** – në krijimin dhe administrimin e dosjeve në Google Drive, ndjekjen e ngarkimit të dokumentacionit nga secili partner dhe verifikimi i plotësisë së tij.

Joana Taçi dhe **Gëzim Sala** përgjegjës në hartimin e strukturës dhe përmbajtjes së disa rubrikave të raportit.

Klaviora Dudumi dhe **Ornela Mera** në mbledhjen dhe përpunimin e dokumentacionit për detajimin e kuadrit ligjor dhe institucional për ngritjen e strukturave për integritetin akademik (AIB/TFAI) në secilin institucion partner.

Kontributi i përbashkët i anëtarëve të Task Forces së EÇUG siguroi përgatitjen në kohë dhe me cilësi të Deliverable D2.1, duke krijuar një bazë të qëndrueshme dokumentare për zhvillimin e mëtejshëm të aktiviteteve të projektit SINCERE.

Pas rishikimit dhe validimit të dokumentacionit të paraqitur, nga kjo Task Force (EÇUG) u konkludua se të gjitha institucionet partnere kanë ngritur dhe formalizuar Task Forcën për Integritetin Akademik në përputhje të plotë me kërkesat e WP2/T2.1, duke përmbushur me sukses objektivin specifik të projektit brenda afatit të përcaktuar.

10:59



79



Erinda's Notetaker + 16



Erinda Papa (Presenting)



12 others



10:53


81



Erinda's Notetaker + 16



Erinda Papa (Presenting)





5 others

10:55

80



Erinda's Notetaker + 16



Erinda Papa (Presenting)



11:07



Brikela + 12

